



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

### VENDIM

Nr. 170, datë 28.05.2020

#### PËR

### NGRITJEN E KOMISIONIT TË PËRKOHSHËM PËR SHQYRTIMIN E ANKIMEVE KUNDËR VENDIMEVE TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR ARKIVIMIN E ANKIMIT OSE PUSHIMIN E HETIMIT NDAJ NJË GJYQTARI

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 62, pika 13 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenet 121, 122 dhe 134 të ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit,

#### VENDOSI:

1. Ngritjen e Komisionit të Përkohshëm për Shqyrtimin e Ankimeve Kundër Vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për Arkivimin e Ankimit ose Pushimin e Hetimit ndaj një Gjyqtari (Komisioni i Përkohshëm), i përbërë nga tre anëtarë, dy anëtarë jogjyqtarë dhe një anëtar gjyqtar, si dhe dy anëtarë zëvendësues.
2. Përbërja e Komisionit, parashikuar në pikën 1 të këtij vendimi, do të bëhet me short, në mbledhjen plenare të Këshillit, dhe do të ripërtërihet, brenda muajit janar të çdo viti. Kryetari i Komisionit caktohet nga Kryetari i Këshillit.
3. Shqyrtimi i ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që janë objekt i Komisionit do të bëhet për të gjitha ankimet e regjistruara gjatë vitit 2020, duke ndjekur, radhën e regjistrimit të tyre në regjistrin e protokollit. Çdo veprim, për shqyrtimin e ankimeve, dokumentohet në procesverbal. Komisioni asistohet nga nëpunës të administratës të caktuar nga Kryetari i Këshillit.
4. Komisioni i Përkohshëm vendos me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve. Vendimi është përfundimtar dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e komisionit, siç është rënë dakord.
5. Komisioni i Përkohshëm, pas shqyrtimit të ankimit, në përfundim të procesit, vendimmarrjen në lidhje me të, duhet t’ia njoftojë ankuesit, magjistratit, Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
6. Shorti për zgjedhjen e anëtarëve të këtij komisioni, në funksion të pikës 2 të këtij vendimi, organizohet në 1 kuti/vazo transparente në të cilën vendosen goglat të cilat përmbajnë

shiritat e letrës me emrat e anëtarëve të Këshillit. Kryetari i Këshillit nuk është pjesë e shortit.

Hedhja e shortit bëhet sipas procedurës dhe radhës së mëposhtme:

- a) Përzgjedhja e anëtarëve jogjyqtarë - Në një vazo transparente futen 4 gogla të njëjta, pas veçimit nga ky proces të Kryetarit të Këshillit, në të cilat futet nga një shirit letre me emrat e secilit anëtar jogjyqtar. Tërhiqen me radhë, dy gogla, dhe lexohet me zë të lartë emri i anëtarëve në shiritin e letrës që ndodhet brenda në këto gogla, duke e treguar këtë para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve. Këto dy anëtarë jogjyqtarë, emrat e të cilëve gjenden në shiritat e letrave, do të jenë anëtarë të Komisionit të Përkohshëm. Ndërkohë tërhiqet dhe një gogël e tretë, dhe emri i anëtarit në shiritin e letrës që gjendet në të, konsiderohet anëtar zëvendësues i Komisionit të Përhershëm.
  - b) Përzgjedhja e anëtarëve gjyqtarë - Në një vazo transparente futen 6 gogla të njëjta, ku në secilin prej tyre futet një shirit letre me emrat e anëtarëve gjyqtarë. Tërhiqet një gogël dhe lexohet me zë të lartë emri i anëtarit që gjendet në shiritin e letrës, duke e treguar këtë para anëtarëve të tjerë dhe pjesëmarrësve. Ky anëtar konsiderohet anëtari gjyqtar që do të jetë anëtar i Komisionit të Përkohshëm. Ndërkohë tërhiqet dhe një gogël e dytë, dhe emri i anëtarit në shiritin e letrës që gjendet në të, konsiderohet anëtar zëvendësues i Komisionit të Përhershëm.
7. Komisioni harton rregulla lidhur me ushtrimin e veprimtarisë së tij të cilat miratohen nga Këshilli në mbledhje plenare.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**